

KOQO RJA

Ballina: Rina Ramadani
Foto: Norik Uka

POPULLI
ME BUKË E KRIPË,
POLITIKANËT
ME SFILITA NË KUVEND

GJESTI
DO IA BËNTE MAT
SECILIT DEPUTET

PSE MË KA FALË ZOTI
VEÇ PËR PRAPË

RINA RAMADANI

elegante, modeste,
gjithmonë lë mbresë te publiku



POWER HOUSE





Në ballinë: Rina Ramadani

NORIK UKA

**Elegante, modeste,
gjithmonë në mbresë
te publiku**



Në një botë ku muzika ndryshon çdo ditë, Rina Ramadani arrin të ruajë një magji që vetëm pak artistë e zotërojnë, aftësinë për të komunikuar me zemrën e publikut.

Me një zë që herë të përkund si valët e lehta të një mëngjesi pa zhurmë, e herë të trazon me emocionin e vërtetë, Rina ka ndërtuar një identitet të veçantë artistik që vështirë se harrohet.

Ajo nuk këndon vetëm për t'u dëgjuar, por më shumë për të lënë mbresë te publiku. Në çdo paraqitje të saj ndjen përkushtimin, shpirtin dhe pasionin që e bëjnë muzikën e saj të veçantë.

Elegante, e thjeshtë dhe gjithmonë në kontakt me publikun, Rina ka fituar zemrat e shumë dëgjuesve, jo vetëm për talentin, por edhe për natyrën e saj të ëmbël dhe të sinqertë.

Rina Ramadani është një nga ato artiste që nuk ndjek vetëm ritmin e kohës, por krijon ritmin e saj — një ritëm që të frymëzon.

Si nisi gjithçka në botën e muzikës?

- Nga shkolla fillore e kuptova se muzika ishte pjesë e shpirtit tim. Talenti më drejtoi natyrshëm drejt skenës.

Cila këngë të hapi rrugë?

- "Një shishe ujë", me muzikë nga Edon Ramadani dhe tekst të Aida Barakut, një nisje e mbarë për karrierën time.

Kush ishte personi i parë që të duartrokiti?

- Familja ime, sidomos prindërit, besuan gjithmonë në mua...

A e mendoje veten mes yjeve të muzikës?

- Po, sepse u rrita pranë artistëve dhe e ndjeja se aty e kisha vendin.

Hiti yt më i madh?

- Çdo këngë që ngjall emocion në publikun tim është një hit për mua.

Bashkëpunimi me Ilir Shaqirin?

- Një ëndërr e realizuar dhe një nder i madh për mua.

Muzikë zbatimëse apo popullore?

- Të dyja. Nuk mund t'i ndaj – i dua njësoj.

Dasmat dhe ahengjet?

- Përgjegjësi e madhe, por edhe një nder i jashtëzakonshëm të jem pjesë e momenteve të tyre të lumtura.

Kënga më emocionale në kanagjegje?

- Varet nga rasti, por gjithmonë ka këngë që prekin shpirtin.

Kush ka kënduar për ty në kanagjegj?

- S'kam pasur ende.

Bashkëshorti – krahu yt i djathtë?

- Po, përkrahja e tij ka qenë thelbësore në çdo hap timin.

Kritika?

- Më së shumti nga Agoni dhe ato më ndihmojnë të rritem.

Jeta larg skenës?

- E qetë, familjare dhe me vlera të thjeshta.

Sa kohë i përkushton dukjes?

- Aq sa duhet, por varet edhe nga rasti.

Pika jote e fortë?

- Morali dhe karakteri.

Planet?

- Shumë plane të mëdha më presin, por do të realizohen me kohë e me shumë pasion.

Të faleminderit për këtë bisedë të veçantë!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri





Populli me bukë e kripë, politikanët me sfilata në Kuvend!

Populli është lodhur. Për nga lodhja më ngjanë si në rastin e kuajve të Sadikut, të Anamoravës. Sadiku kishte qenë burrë shakaxhi dhe shkonte në dasma odë më odë. Kishte ditur edhe të këndonte...

Në një dasmë, e cila bëhet në pranverë, e pyesin:
"A munde t'i nxjerrësh kuajt në Shëngjergj, o Dik?", kështu e thërrisin shkurt Sadikun.
"Goxha mirë: Njëri kalë gati ngrihet vetë në këmbë, e tjetrit pak me i ndihmu qohet!", përgjigjet Sadiku.
Kështu është edhe me popullin tonë: i lodhur e i dërmuar tej mase...
E, në formë janë politikanët: postet nuk i lëshojnë, sorollatën në Kuvend si duan vetë!
Një burrë e kishte pyetur Dikun - pse

lodhen sytë?
Burri pleqnar i ishte përgjigjur që të merr syze në mënyrë që t'i mbrojë sytë...
Por, edhe me syze mund të sharrosh, ishte përgjigjur ai.
Shkon një plak te mjeku dhe merr syze zmadhuese. Me syze niset ta kalojë lumin Nerodime, lum me ujë të kthjellët që vjen nga bjeshkët e Jezercit. Shikon e shikon ku ta hedhë këmbën dhe i duket se kishte vend të mjaftueshëm mbi një gur, e që syzet zmadhuese ia kishin zmadhuar bukur fort. Lëshon këmbën mbi guri, duke

menduar se është i madh dhe sharron deri në kërdhokull. Në ato çaste i kujtohen fjalët e Dikut: Mund të sharrosh edhe me syze!
Kështu po ndodh edhe me dialogun Kosovë-Serbi. Kosova me Kushtetutën e vet, Serbia me të veten! Kujt t'i besohet? Kur e dëgjon Vuçiçin del se ka humbur Kosova, e kur e dëgjon Kurtin thua - Serbia do të mbetet vetëm me Pashallëkun e Beogradit...
Por, një gjë është e sigurt: Dikush do të fitojë e dikush do të humbë...

Isa ILAZI

DURIMI - NË MAJE TË HUNDËS!



*Zoti ua ka dhënë një fytyrë, e ju e bëni një tjetër.
E trishtueshme është kjo!*

I PASHPRESI...

Pakënaqësia e qytetarëve, mosbesimi dhe zhgënjimi nga institucionet është gjithnjë duke u shtuar, duke u rritur.

Veprimet e pandryshuara që 17 vjet pas shpalljes së Pavarësisë, ka bërë që edhe fjala shtet të mos ketë aq rëndësi, siç është dashur ta ketë, siç edhe e kemi menduar e pritur...

Në të gjitha institucionet tona, me ndërrimin e stafit politik, e që ndërrohet në çdo ndryshim qeverie, stafi tjetër punësohet pa kriteret dhe në mënyrë jo transparente.

Rrallëherë institucionet tona shpallin konkurs publik për punësim, ndërsa përditë punësohen punëtorë të rinj.

Pra, punësohen pa konkurs publik!

Punësohen ata që janë të afërm të menaxhmentit, të politikanëve e të tjerëve që kanë poste.

Dhe, në ato institucione mund të takohesh me filanin a filanen që është mik, dhëndër, kunatë, baxhanak, dashnore a sepër tjetër me dikë që është në krye të atij institucioni publik a politik...

"Vallahi, bre dost, veç mund t'i dorëzosh dokumentet, se as ymyt mos mbaj se mund të punësohesh në atë vend pune, në të cilin një fisnike ka kohë që punon...", më thotë Ragip Ruhani, fjalët që ia kishte thënë njeriu që punonte në sportelin e institucionit ku kishte konkurruar.

Ragipi është rreth të pesëdhjetave. Moti ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik. Është i martuar dhe i ka tre fëmijë të rritur. S'ka lënë vend pa konkurruar, ku edhe dëgjon se është hapur konkurs...

Por, kot!

"S'kam kurrfarë lidhje, o vëlla!", më thotë i zhgënjyer dhe i pashpresë se do gjej punë.

Andaj, jeta ia imponon të mendojë ta lëshojë Kosovën.

E, ky është vetëm një nga shumë të tjerë, të cilët janë mbushur me premtimet e liderëve dhe gjithnjë e më shumë po e humbin durimin...

LUTJA

Njerëzit e varfër, të uritur, nuk frustrohen me jetën. Ata nuk mund të jenë të frustruar.

Ata nuk kanë jetuar ende.

Por, jetojnë me shpresën...

Skamnori përherë e ka shpresën.

Skamnori gjithmonë shpreson se diçka do të ndodhë – nëse jo sot, atëherë nesër.

E, në qoftë se jo në këtë jetë, atëherë në jetën tjetër... Eh, në jetën tjetër!

*

Lutja e njeriut që i bëhet Zotit s'duhet të thuhet më: "Falna mëkatet tona!". Por: "Ndëshkoni, o Zot, për paudhësitë tona!"

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruçi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Tmerri që nuk harrohet kurrë...



Gjatë hulumtimeve për mbetjet mortore në Kralan të Gjakovës

“Babai kërkoi ta pushkatonin në vend timin!”

Më 2 prill të vitit 1999 në fshatin Kralan të komunës së Gjakovës forcat ushtarake dhe policore serbe zgjodhën disa qindra djem dhe burra nga grupi prej 1.500 shqiptarëve, të cilët kishin braktisur vatrat për t’u shpëtuar krimeve serbe dhe nga ta 86 sish i vranë...

Më 2 prill 2025 u mbushën 26 vjet nga vrasja e 86 civilëve në Kralan të Gjakovës. Dy ditë më vonë, më 4 prill, nga grupi i djemve dhe burrave

të cilët janë mbajtur në livadh, gjatë gjithë kohës të rrethuar me tanke (pa ujë e pa ushqim), një numër i tyre ishin liruar.

Por, nuk i liruan 86 djem e burra, ndër të cilët edhe 11 të mitur. Që nga ajo ditë, që nga ai moment deri para pak kohe askush s’ka ditur ku janë varrosur.

Sidoqoftë, kohë më parë janë gjetur eshtrat edhe të tri viktimave të luftës së vitit 1999, konkretisht viktima të Masakrës së Kralanit të Gjakovës. Kështu, pas 26 vjet pritjeje dhe kërkimi, u informuan familjet për identifikimin e mbetjeve mortore (eshtrave) të cilët ishin në Listën e Personave të Zhdukur që nga koha e luftës. Ata ishin: Sabedin (Kadri) Kryeziu, nga fshati Mleqan i Malishevës; Mentor (Maliq) Kryeziu, nga fshati Bubavec i

Malishevës dhe Vehbi (Pajazit) Halilaj, nga fshati Llapqevë i Malishevës. Këto tri identifikime vijnë pas identifikimeve të tetë viktimave të tjera nga e njëjta masakër, eshtrat e të cilëve u gjetën dhe u zhvarrosën nga lokacioni i varrit masiv në Bishtazhin të Gjakovës.

Por, një storie televizive që u dha në njërin nga televizionet tona ishte, vërtet, tmerruese. Naim Ismajli, i cili ishte në mesin e personave për pushkatim në Kralan, tha para kamerave televizive: “Babai im u lutej policëve serbë që ta pushkatonin atë e t’me lironin mua”.

Dhe, për çudi, ashtu edhe kishte ndodhur: e kishin liruar Naim Ismajlin, i cili aso kohe ishte shumë i ri dhe e kishin rreshtuar në rresht babanë e tij, i cili që nga ajo kohë ishte i zhdukur.



“Gërnaçi” i thotë vetes zagar!

Në një odë që isha ditë më parë, u bisedua se po hamë edhe mish gomari, madje! Por, para se të flasim për mishin e gomarit, duhet të tregojmë se këtë muhabet, e që Ramush Haradinaj i thotë “kjo temë”, u hap në një odë që dera e saj hapet një herë në vit, sa herë që pronari i saj vjen nga Gjermania, e që vetes i thotë se ka mbetur as qen e as zagat!

Ditë më parë erdhi nga Gjermania një mik imi, i cili vjen rrallë, ndoshta një herë në vit.

Dhe, sa herë që vjen e hapë derën e odës për fqinjët dhe miqtë.

Në odën e tij bisedohet mbarë e mbrapsht, siç thuhet në popull.

Por, ajo që na bëri të qeshim të gjithëve ishte kur bashkatdhetari ynë tha se ka mbetur as qen e as zagat, me demek as me shehër e as me Barilevë siç thonë në Prishtinë, sepse kur është në Gjermani mendja i rri në vendlindje, e kur vjen këtu mendja i rri te familja e tij në Gjermani. Azizi, shakaxhiu i mëhallës, pak si me shaka e pak si përnjëme, i tha të mos e quante bile veten qen a zagat, por i zoti i odës i tha troç:

“Unë, bre burrë, i kam 78 vjet dhe këtë odë ma ka lënë baba. Nuk po kam shpirt as ta rrëzoj, as ta mbaj! Nuk është odë ajo që hapet një herë në vit një a dy javë sa

qëndrojnë në Kosovë!

Sa herë vij e hapi derën e odës. Më bëhet se e shoh babën ulur në postajë ogji pranë koftorit, i cili dimrit tërë ditën rrinte i ndezur.

I shoh edhe burrat që rrinin rreth koftorit, vakt që m’i kujton kohët e mira kur oda ishte e mbushur me burra...

E, kur nisem për në Gjermani, teksa e mbylly derën e odës, më bëhet sikur e shoh nënën teksa më përcillte te dera e oborrit dhe më dëshironte rrugë të mbarë...”

Ndërkohë, vjen dreka në odë dhe ndërpritet muhabeti.

Sofra mbushet me të gjitha të mirat e Zotit...

Nuk thonë kot “Sofra e Lubishtes së Vitisë”...

Pse?

Sepse sofra e Lubishtes mbushet me prodhime vendore. Patatja, fasulja, mishi i terur i gjedheve që i mbajnë në shtëpi,

janë prodhime që i kanë në shtëpi, e jo mish kali a gomari, siç shitet për mish llope në mishoret tona!

1 GOMAR E 9 KUAJ NË SHITJE!

Para një kohe ndodhi një befasi. Dogana e Kosovës, e terminalit doganor te Dheu i Bardhë, nxori në shitje 9 kuaj dhe 1 gomar. Çmimi 1 euro për kilogram.

Ku i morën?

Kuajt dhe gomarin i konfiskuan në aksionin policor-doganor, si kontrabandë e kafshëve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sidoqoftë, nuk dimë a janë shitur a jo kuajt e gomari, por, sipas fjalëve të miletit, ata janë blerë nga disa mishore që e kanë primare prodhimin e suxhukut.

Andaj, një Zot e di se çka qesin tregtarët në suxhuk?!

Jam nëna e lotëve...

Kur të tjerët qeshin- unë qaj!

*Ka diçka që ju gëzon
edhe kur jeni të lënduar,
por ka edhe diçka që u
lëndon gjatë gëzimit. Ka
diçka që u bën me lot nga e
kaluara pikëlluese, por ka
edhe diçka që u gëzon edhe
kur jeni me lot pikëllimi.*

GËZIMI DHE LOTËT PËR NGJYRAT E SYVE

Nuk ngopesha me kureshtjen rreth universit. Bija natën mbi barë të oborrit dhe shikoja yjet në qiell. Lëvizja e tyre më kishte vënë në gjumë sa e sa herë. E, nëna më merrte e më vendoste në shtratin e dhomës së shtëpisë së vjetër. Por, kureshtja vazhdonte për gjithçka. Ndalesha në pasqyrë dhe e shikoja veten. Dukësia mu si këlyshi i vogël, tek kafeneja ku pimë kafënë e mëngjesit. Këlyshi i vogël e shikonte veten në xhamin e ndërtesës dhe i hidhej xhamit për ta kapur këlyshin andej xhamit.

E, i vetmi dallim nga kjo storie ishte se unë nuk i sulesha xhamit të pasqyrës për ta prekur vet-veten... Por, pasdite më kishte kapluar nostalgjia për të kaluarën. Takova shoqen e nënës dhe ajo nisi të qante për shoqërimin që kishin pasur me nënën time.

Tregoi një storie, pastaj një tjetër dhe, në fund, më bëri të qaj edhe unë. I mallëngjyer nga tregimet rashë të flija. Gjumi i parë më lidhte me pasqyrën. Ishte diçka në mesin e të gjitha mallëngjimeve. Isha ndalur pranë pasqyrës në banjë. Doja të rruhesha, por edhe t'i pastroja dhëmbët.

Po, i thashë vetes, sa shumë i kam ruajtur dhëmbët... Dhe, kam të drejtë të mburrem, sepse këtë më parë ma kishte thënë edhe një doktoreshë.

I shikova dhëmbët, por mendja më vajti tek njerëzit që në fëmijërinë time flisnin për sytë e mi. Dhe, me kalimin e kohës, nuk kisha pasur kohë të shihja nëse sytë e mi kishin atë magnetizmin që ma kishin thënë dikur. Sa budalla jam bërë, fola vetë me vete. Thellova shikimin në pasqyrë,

për të gjetur ngjyrat e dikurshme, por nuk i pashë.

A thua, do të jenë tretur?

A thua, do të jenë shlyer?

Megjithatë, nuk pajtohem të mos bindem nëse janë ende ngjyrat e syve të mi, apo, vërtet, kanë ikur nga sytë e mi...

Ndoshta ngjyrat në sytë e mi janë ende, por unë nuk po i shoh, i thashë vetes. Por, për këtë kam zgjidhje. I marrë syzet, i vendosi mbi sy dhe i drejtohem pasqyrës. Oh, Zot, ja ku janë ngjyrat e syve! Të gjitha qenkan aty, por unë nuk i shihja pa syze!

E, nëse nuk i shoh ngjyrat e syve të mi, çka mund të shoh tjetër?! Dhe, në çast më rrodhën lotët...

Por, i gëzuar isha që i pashë ngjyrat e syve të mi në pasqyrën e banjës. E, i vetmi dallim është se tani ngjyrat i shoh përmes syzave dhe lotëve.

SI E LAGA ME LOT TORTËN E DITËLINDJES?

Ndërrova krahun dhe sapo desha të vazhdoja gjumin, mu mbushën veshët zile. U ngrita dhe u ula në shtrat. Nuk di nëse më kishin bërë veshët, apo do të ketë qenë diçka e mbetur nga fëmijëria? U shtriva sërish në shtrat, me dëshirë ta shihja nënën në ëndërr, me dëshirë që t'i shihja yjet në qiell.

Nuk di, mendova sërish, por mirë është ta lë veten në duart e "qerres së gjumit" dhe ajo t'më shëtis maleve e fushave. Mirë do të ishte që kur të shkonim te "lumi i fëmijërisë" të ndalojë qerrja, për ta dëgjuar gurgullimën e lumit tim, të përjetoja rrjedhjen e ujit. Por, ndërkohë, nga mjegulla doli Drini me tortë në dorë. Vinte ngadalë, e pas tij edhe disa fëmijë të tjerë. Mbanin në duar xixa dhe numra dhe këndonin këngën e

ditëlindjes.

"Kah kjo ditëlindje?!", pyeta veten.

U ofruan rreth meje dhe qeshnin me mua, duke kënduar këngën: "Shumë urime për ty!"

Unë, në vend që të qeshja, heshta. Nuk më qeshej. Por, më duhej të aktroja se kinse më shkonte buza në gaz.

Vërtet, kurrë nuk kam qeshur me plot gaz. I lakmoja të gjithë ata që qesheshin me të madhe...

Sepse, mua e qeshura e madhe nuk më rri mirë në fytyrë...

Për çudi, njerëzit shumë gëzohen kur festojnë ditëlindjen! Ditëlindja u jep gëzim, kurse harrojnë se për çdo ditëlindje më afër e kanë vdekjen se kurrë më parë...

Dhe, e marrë thikën ta preja tortën dhe më ranë lotët mbi tortë.

Thashë: Janë lot gëzimi...

I gënjej fëmijët se të gjitha vitet e jetës sime kanë qenë të mira, por kësaj ditëlindje i mungon dikush që e dua shumë...

E, tek qaja, erdhi ajo...

Fill pas kësaj, hetoj dorën e gruas sime, e cila më lëkundë që t'më del gjumi, sepse kisha filluar të dënesja, të lëshoja zëra pa lidhje...

LOTËT FESTIVË...

Qëndrova pakëz ulur dhe ndërrova anën e jastëkut. Pas pak më zuri gjumi sërish, i ngarkuar me mallëngjime e lot.

Dhe, vjen edhe nata festive. E, kur vjen ajo natë, askush nuk mendon se do të vazhdojë jeta tutje, askush nuk di se do të rriten brengat dhe jeta do merr një trajtë edhe më të lakuar...

Isha liruar nga gjithçka. Më nuk kisha lot për jastëkun, e as për shpirtin tim të lënduar. Nata e fundvitit do të më relaksonte. Do të pija një gotë verë të kuqe, e, më pas, edhe një tjetër dhe çdo gjë do të bëhej rrafsh...

S. M.



A ka dreqër në Gadime?

Para një dekade është shtruar asfalti dhe lugina “Klisyрка” ka shpалosur bukuritë mahnitëse. Mirëpo, para se ta lidhte asfalti Gjilanin me Lipjan, lugina ruante jo vetëm bukuritë mahnitëse, por edhe rreziqet për kalimtarët. Ajo nis me të mbaruar Gadimja e Epërme dhe përfundon me të hyrë në fshatrat e Gjilanit: Kishnapolë, Sllakoc, Zhegoc, Gadish.

Historiku i fshatit thotë se emri i fshatit më të madh në Kosovë, Gadime, rrjedh nga fjala ilire Gradina, që shtrihet rrëzë maleve mbi Gadimen e Epërme.

Aty ishte derdhur gjak në luftëra të ndryshme.

Rrallë ndodh të gjesh një mitologji aq të pasur me ngjarje të dukshme dhe të padukshme që përbëjnë një histori të tërë gjërash që ka mundur t'i ruajë deri në ditët e sotme vetëm lugina “Klisyрка”, përgjatë të cilës rrjedh lumi me po këtë emër.

Ç'THONË FSHATARËT?

Më i vjetri në këtë anë, Qamil Tasholli, thotë se për ta deshifruar luginën duhet të lidhemi me gojëdhënat.

Është nja dhjetë kilometra gjatësi lugina që ruan ende mitet e së kaluarës...

“Dikur në Gadime malësorët sillnin dru për shitje.

Vinin nga bjeshkët në rrafsh.

Në atë kohë bjeshkët kanë qenë me shumë drunj e jo si tash.

Një shitës, teksa vinte për në Gadime me qerren mbushur dru, rrugës i kishin dalë qoftëlargët dhe ia kishin ndalë qerren. Besa edhe ia kishin përmbysur qerren në mes të lumit!

Dhe, një gjë e tillë kishte ndodhur shumë herë.

Kështu tregonin të vjetrit në kohën kur unë isha i ri”, thotë Qamil Tasholli, më i vjetri i Gadimes, në kohën kur bëmë bisedë me të.

Dhe, për të dëshmuar se ka ndodhur, vërtet, diç e tillë, përgjatë luginës ka pasur mullinj që në një kohë bluanin banorët e Gadimes dhe të fshatrave përreth.

“Pleqtë tregonin se u kishte ndodhur që derisa prisnin të bluanin në mulli, mbi kulmin e mullirit dëgjohej rrapëllima e

gurëve, të cilët pastaj rrokulliseshin dhe binin në tokë...

E, kush gjuante gurë?

Naletët se kush tjetër?!”, thotë Qamili.

ZANAT E MALIT TË “KROI AKULL”

Flitet se zanat e malit njiheshin si bukurshet e pakrahasueshme dhe u dilnin udhëtarëve natën teksa ndalonin të pinin ujë të “Kroi akull” që ndodhej në mes të ahishtës.

Dhe, se ndodhte një gjë e tillë Qamili thotë se nga të parët kishte dëgjuar se Muharremi, fqinjit të tyre, i kishin dalë para tri zana dhe njëra prej tyre e kishte rrokur për krahu dhe e kishte tërhequr nga brendia e pyllit, e që pastaj e kishte humbur rrugën dhe deri në mëngjes kur ishte zdritur nuk dinte se ku ndodhej...

S. Murturi

SHTYLLAT E SHËNDETIT



USHQIMI

SHËNDETI



GJUMI



LËVIZJA

Më ka ndryshuar jeta...

Keq
jam dashuruar,
por jo
në burrin tim!

Jam një grua e martuar. Ndihem shumë keq për mendimet që më kalojnë nëpër kokë, por nuk di se si ta frenoj veten. Jeta ime familjare po turbullohet çdo ditë e më shumë shkaku i një ndjenje që ka lindur brenda meje. Nuk dua t'ia pranoj as vetes, por qenka e vështirë që të mbysësh zërin e ndërgjegjes...

Jam martuar me mesit. Ma prezantoi teza e burrit, të cilën e kishim fqinj. Më pëlqeu im shoq që në takimin e parë. Unë isha vajzë e vetme dhe prindërit më kishin qëndruar para e mbrapa gjatë gjithë kohës. Nuk kam pasur kurrë të dashur apo ndonjë histori dashurie përpara se ta njihja tim shoq.

Kam qenë një vajzë e mbyllur në vetvete dhe nuk kisha shumë shoqëri. Im shoq ishte njeriu i parë që më bëri të ndihesha mirë.

Ashtu, siç thashë, më pëlqeu që në takimin e parë dhe i thashë familjes se isha dakord që ta lidhja jetën me të. Edhe Fitimi kishte shprehur pëlqimin e tij...

Kështu, filluam të takoheshim gjithmonë e më shpesh derisa brenda muajit bëmë edhe fejesën.

E DASHURUAR PO, POR...

Nuk mund të them se ditën e fejesës isha aq e lumtur, siç ndodh në filma, por as nuk mund të them se isha e trishtuar. Ishte një fejesë e thjeshtë dhe unë ndihesha mirë. Nuk dyshova për asnjë çast se po merrja një vendim të gabuar.

E dija shumë mirë se në rrethinën time nuk kisha për të pasur rast më të mirë. Iu gëzova faktit se do të shkoja të jetoja në qytet me një njeri që më pëlqente.

Brenda tre muajve bëmë dasmën. Nuk kaloi shumë dhe u bëmë me fëmijë.

Im shoq mezi e priti këtë moment.

E kishte fiks të kishim një fëmijë dhe kjo dëshirë e madhe iu realizua.

Marrëdhëniet tona ishin të mira. Ishim një çift i qetë dhe nuk ndodhte të grindeshim me njëri-tjetrin.

Madje, kur na ngelte hatri apo mërzhiteshim me njëri-tjetrin, preferonim të mos flisnim fare...

Burri im kishte një shok të ngushtë që jetonte prej vitesh në Zvicër. Madje, kishin jetuar disa vjet edhe bashkë në Zvicër.

Burri gjithmonë më fliste për të. Më saktë, në çdo histori që më tregonte përmendej edhe emri i tij.

Në njëfarë mënyre isha bërë kurioze ta njihja atë njeri...

SIKUR KISHTE VITE QË MË NJIHITE...

Një ditë im burrë më tha se kishte ardhur ai, shoku i tij, me të shoqen e dy fëmijët. Një ditë e kishte ftuar në darkë në shtëpinë tonë, që të njihesha edhe unë me të, meqë që kur isha martuar nuk kisha pasur rastin ta takoja.

Ai erdhi me familjen e vet. Unë kisha përgatitur darkë të mirë. Që kur e pashë më la përshtypje të mirë, ndoshta ngaqë ishte shumë i pashëm. Ishte burrë i gjatë e me trup të formuar.

E shoqja më dukej sikur ishte disa vjet më e vjetër se ai. Fëmijët i kishte si pëllumba. Akoma më shumë më pëlqeu gjatë bisedës, sepse bënte shaka e qeshte me tim shoq.

Ishte shumë i komunikueshëm dhe nisi t'më trajtonte menjëherë sikur kishte vite që më njihje.

Edhe e shoqja ishte grua e afrueshme, andaj e kaluam shumë mirë atë darkë në shtëpinë tonë...

Kur shkuan bisedova gjatë me tim burrë për ta...

SI NISI T'MË PËLQENTE SHOKU I BURRIT?

Ata do të qëndronin në qytetin tonë tri javë. Takoheshim përditë me ta dhe organizonim aktivitete të ndryshme, që të kënaqeshin edhe ata, edhe fëmijët.

Me kalimin e kohës u afrova shumë me shokun e burrit. Më pëlqente të bisedoja me të. Më dukej sikur më kuptonte edhe për disa gjëra që im burrë nuk më kishte kuptuar ndonjëherë.

E shoqja i fliste gjithmonë me ëmbëlsi dhe e lavdëronte...

Dukej se ishte njeri shumë i përkushtuar.

Edhe unë shkoja mirë me burrin tim, por kisha edhe gjëra që nuk më pëlqenin dhe nuk e lavdëroja në sy të të tjerëve.

Gjithsesi, dua të them se ai nisi t'më pëlqente gjithmonë e më shumë.

E gjeja veten duke u përpjekur të rrija vetëm me të, vetëm e vetëm që të bisedoja.

Andaj, nisa të mendoja vetëm për të... Mezi prisja ta takoja...

Në anën tjetër, burrit tim i vinte mirë

që unë kisha zënë shumë miqësi me shokun e tij të ngushtë dhe as që i shkante në mendje se kjo mund të ishte e rrezikshme...

SI NISA TA XHELOZOJA GRUAN E SHOKUT TË BURRIT?

Më vjen turp ta pranoj, por fillova të ndieja xhelozia për gruan e shokut të burrit, që ishte aq me fat dhe kishte një burrë si ai.

Mendoja se ajo nuk ishte aq e mirë sa ai dhe përsëri kishte pasur fat që kishte gjetur një burrë të përkryer. Fillova të dëshiroja që të isha në vendin e saj, edhe pse më vinte turp nga kjo dëshirë e pakontrolluar.

Ato tri javë kaluan shpejt dhe shoku i burrit me të shoqen do të ktheheshin në Zvicër. U bëmë shokë edhe në "Facebook", që të shkëmbejm fotografitë që bëmë gjatë qëndrimit të tyre në qytetin tonë.

Ai e përdorte më shumë se e shoqja "Facebookun", prandaj edhe unë nisa të komunikoj me të. Ia nisja fotografitë dhe ndonjëherë i dërgoja edhe ndonjë mesazh, ku e pyesja se si ishte ai dhe familja e tij.

Ai tregohej gjithmonë shumë i sjellshëm në përgjigjet që më jepte...

BURRI IM KA BESIM NË MUA...

Nuk e di se si nisi një lloj komunikimi disi i rrezikshëm. Në pamje të parë nuk kishte asgjë të keqe, por herë pas herë flisnim me kunja. Këto ishin momentet më të këndshme... Nuk guxoja as unë dhe as ai t'i thoshim gjërat troç, por ama ia lejuam vetes që të flirtonim në një mënyrë të kamuflluar. Shkurt, kam filluar të ndiej shumë për shokun e ngushtë të tim shoqi. Më duket se për herë të parë në jetë po provoj se çfarë është dashuria. Por, nuk dua as t'më paragjykoni, sepse nuk dua as të prish familjen time e as familjen e tij, por vetëm se vetes nuk mund t'ia fsheh këtë ndjenjë.

Megjithatë, shumë dilema kam brenda vetes. Kam frikë se mos ai merr guximin të shkojë më larg sesa ato biseda në internet...

D. T.



Gjesti do ia bënte mat secilit deputet!

Dita e votimit është një uragan që lë pas vetes llumin e asaj që ka ndodhur. Një zonjë që e kishte vajzën kandidatë për deputete, i kishte hyrë lagjes sonë derë më derë për të siguruar votat e saj, duke premtuar parajsë në lagjen tonë...

I pari që ndodhej ulur afër meje e hapi temën, kurse i dyti e i treti, duke treguar se nëna e kandidatës i paska hyrë rend lagjes shtëpi më shtëpi për të kërkuar vota, madje duke lënë edhe nga një grusht kartëvizita me emrin dhe numrin e vajzës së saj, muhabeti doli edhe te pika kryesore kur e pyetëm njëri-tjetrin nëse e kanë votuar dhe përgjigja ishte një aha e madhe... Nëna e kandidatës ka menduar se e tërë lagjja është me një parti, pa ditur se mëhalla janë të ndarë në parti të ndryshme. Kartëvizitat e kandidatës kishin përfunduar në kontejnerë.

Andaj, ky proces i ngjanë më shumë një uragan kur pas shiut uji është i turbullt dhe kudo njeriu hasë në bërllok, gurë, drunj dhe llum. Pra, është interesante se si njerëzit sot nuk i thonë jo askujt që kërkon votën, por në fund askush s'të voton!

SA VOTA DO TË MERRTE GJESTI?

Aktualisht, sipas popullaritetit të skenës së votës, nëse fituesi i "Big Brother Albania 4", Besart Kelmendi, i njohur me nofkën "Gjesti", do të ishte pjesë e politikës, do të ishte më i votuari në Kosovë e Shqipëri.

Dhe, jo vetëm më i votuari, por bindshëm më i votuari...

Gjesti ka miliona klikime e ndjekës në rrjete sociale dhe ka bërë popullaritet të jashtëzakonshëm në shtëpinë e famshme që del të jetë më e shikuara nga shqiptarët vendorë dhe në diasporë.

Njëri prej atyre që ka qenë në "Big Brother VIP Kosova" ka qenë kandidat për deputet, por ka dështuar që në start, ndërsa kjo nuk do të ndodhte me Gjestin, sepse ai edhe në debatet politike do ua jepte mat gjithsecilit...

Pra, kandidat se jo mahi?



MUNDËSIA PËR TË BLERË
BANESËN TUAJ
TANI E KENI PËR VETËM ME

10000€
PJESËMARRJE

ME AFAT KTHIMI DERI NË

20 vite



+383 49 509 090
+383 48 581 888



info@cimaks.com
www.cimaks.com



Pse ia arrestuan të birin **Petro Markos?**

Shkrimtari i madh shqiptar, Petro Marko, kishte provuar shumë burgje dhe vuajtje, por asnjëra nuk ishte aq e madhe sa ajo që përjetoj atë ditë gushti të vitit 1975, kur ia arrestuan të birin. Përjetimet e shkrimtarit në ditën e arrestimit të të birit dhe në vitet që e ndoqën, të shkruara nga vetë ai...

Me arrestimin e të birit shumë të njohur e miq as nuk do i flisnin, por shkrimtari nuk bën me faj askënd. Frika kish modifikuar sjelljet njerëzore. Të rrallë ishin ata që e mposhtën frikën për hir të miqësisë, si Koço Kosta, që u kthye nga rruga dhe i tha: "Do të të përqafoj një herë, pa le të më varin!". Ishte afruar si një dallgë vigane, me një uturimë të brendshme, e pash-mangshme, derisa ishte përplasur mbi ta.

DALLGA E RADHËS NË JETËN

E PETRO MARKOS...

Mesnatën e 7 gushtit 1975 forcat e Sigurimit kishin hyrë në shtëpinë e Petro Markos dhe kishin arrestuar djalin e tij, Jamarbërin. Ishte dallga e radhës në detin e

trazuar të jetës së Petro Markos, por asnjë më parë nuk kish qenë kaq shkatërruese.

"Më 7 gusht 1975, në orën 12 të natës, djali u arrestua në shtëpi..."

Pasi i vunë prangat djalit dhe e morën, nuk lanë gjë pa kontrolluar. Arrestimi i djalit qe gjëja më e rëndë e jetës sime", shkruan Petro Marko në kujtimet e tij, të përmbledhura në librin "Retë dhe Gurët", i botuar mbi 20 vjet më parë. Sidoqoftë, Petro kishte qenë disa herë i dënua, fillimisht në burgjet fashiste dhe më pas për 3 vjet në burgun e Tiranës, i dënua nga pushtetarët e rinj komunistë, siç ishte dhe Petroja në idealet e tij.

Pasi kishte dalë nga burgu, më 1950 kishte provuar njëra pas tjetrës goditjet e sistemit, të cilët i censuronin librat, e kërcënonin me internim, i hiqnin të drejtën e shkrimtarit. Gjatë këtyre viteve rritej edhe i biri, i

cili pak nga pak nisi të kuptojë çfarë ndodhte përreth dhe të revoltohej. Dëshirat e të rinjve, siç shkruan Petro, ishin dhe të tijat: për muzikë të huaj, letërsi moderne, modë perëndimore, flokë të gjatë.

Të gjitha këto ndaloheshin, duke provokuar një zemërim që këta të rinj nuk mund ta përmbanin ndaj dhe shfaqnin mendime kundër sistemit. E dinin që kjo ishte me pasoja, por ata ishin të rinj dhe guxonin.

Djali i Petros, ndiente, veç shtypjes së përgjithshme, edhe goditjet e padrejtësitë që i bëheshin të atit, çfarë e bënte edhe më të vështirë për të ta pranonte sistemin. Kishte mbaruar studimet për gazetari në atë kohë e, megjithatë, nuk po i jepej e drejta e punës.

Ndërkohë, arrestimet dhe internimet shpërthenin rreth e rrotull tyre dhe e bënin atmosferën gjithmonë e më të rëndë.

Ishte burgosur shoku i klasës së gjimnazit, Fatos Lubonja, ishte internuar miku i të atit dhe profesori i tij i fakultetit, Vangjush Gambeta, Dhe, erdhi edhe radha e tij.

Atë natë, Petro, bashkëshortja, Safo dhe e bija, Arianita u gdhinë kokë më kokë, duke menduar se si do u vinte halli pas kësaj, çfarë do ndodhte me punën e Safos dhe studimet e Arianitës, por mbi të gjitha çfarë do të ndodhte me djalin...

"Mora kontakt me hetuesin, një djalë i ri, shumë i sjellshëm. Ai më tha:

"Vetëm një emër të më thotë dhe unë e nxjerr që tani e ta marrësh me vete!". Mbas pesë muajsh në hetuesi, më 31 dhjetor 1975, u dha vendimi i gjyqit: gjashtë vjet heqje lirie për agjitacion dhe propagandë.

E PA DJALIN PAS HEKURAVE SI VETEN DIKUR...

Në takimin e parë me djalin, përpara se të nisej për në Spaç, takim me dy palë hekura mes nesh, ai ishte jashtë mbase i tronditur, i verdhë, i ënjtur, i deformuar.

Ne e pyesnim dhe ai heshtte.

Shqiptoi vetëm disa fjalë të pakuptimta për ne: "Jam këtu për të dytin". Kishte menduar se ne ishim të internuar, pasi gjatë gjithë kohës i tregonin urdhrin e internimit.

Ishim të gjithë jashtëzakonisht të tronditur, por për mua ishte më e rënda, se e pashë tim bir prapa hekurave, njëlloj si veten time", shkruan Petro Marko. Familja do të kalonte ditë të vështira. Miqtë do u largoheshin. Asnjëri nuk i afrohej Petros dhe ai nuk i afrohej askujt.

Nuk bën me faj askënd, në kujtimet e tij, por veçon ata pak që nuk iu ndanë: shokët e luftës së Spanjës, si "i miri dhe i guximshmi Skënder Luarasi". Përmend edhe një episod me mikun, Koço Kosta. Një ditë në bulevard ai po ikte poshtë, por pastaj kishte ndryshuar kah dhe ishte drejtuar për nga Petroja.

"M'u afrua dhe më tha: Do të të përqafoj një herë, pa le të më varin!" Dhe m'u hodh në qafë.

Qetësues kishte qenë dhe një takim me dy lexues, vëlla e motër, nipër të një prej burrave që kishin marrë pjesë në Luftën e Vlorës, që Petroja e kishte bërë personazh në romanin e tij "Ultimatumi".

Familja po shkante për në Fier me tren, për të marrë më pas autobusin drejt Ballshit, ku djali i Petro Markos u transferua në burg, pas Spaçit. Poshtë sediljeve kishin trasta me ushqime dhe ndërresa që i fshihnin me këmbë për t'u dukur si udhëtarë të zakonshëm.

Nuk donin t'i njihje askush, por ja që të rinjtë kishin këmbëngulur sepse dëshironin t'i shprehnin mirënjohje Petro Markos dhe më pas i kishin ndihmuar edhe me trastat, duke i thënë se e dinin për burgun e djalit, se nuk duhej të mërzitej, se ishin gjëra që ndodhnin...

Ata e vizitonin çdo muaj djalin, në fillim në Spaç e më pas në Ballsh, duke u përballuar me vështirësitë e rrugës, vapën në verë dhe të ftohtin në dimër.

"Nuk mund t'i harroj udhëtimet

për në Spaç, hipur mbi karrocëritë e kamionëve në mes të dimrit, në ato male të ashpra ku të ngrinte veriu, unë me një pardesy fësh-fëshe. Në këto rrugë mora shumë herë bronkopneumoni, që më shkaktoi këtë emfizemë pulmonare, e cila po më merr jetën tani", ka shkruar Petro Marko në vitet e fundit të jetës, ndërkohë që kur ende nuk ishin ndryshuar regjimet, përpjekjet e Alfred Uçit, Sofo Lazrit dhe Dr. Shefqet Ndroqit për ta çuar shkrimtarin për kurim jashtë shtetit kishin marrë përgjigje negative. Rruga ishte aq e vështirë sa Petro Marko ka shkruar se mendonte që nuk duhej të udhëtonin të tre bashkë për në Spaç, nga frika mos rrokulliseshin në rrëpira.

"Atëherë ç'do të bëhej me djalin?", ishte frika përmbi frikën për jetën. Ndërsa rrugës drejt barakave të kampit të riedukimit të Ballshit, ngaqë përvëlonte dielli në verë, vinin në kokë lecka të lagura dhe ecnin pambarim të ngarkuar me trasta.

NJË SHKRIMTAR, DY PIKTORE E NJË POET

Ishin një shkrimtar dhe dy piktole, që shkonin të takonin një poet. Ai në burg, por dhe ata të dënuar për pasojë. Ishin një familje e ndarë, pjesët e së cilës afroheshin në humbëtitat e Spaçit dhe Ballshit, por nuk takoheshin dot prej hekurave. Ishte Petro Marko njeriu që pësoi shumë goditje të padrejta, por nuk ia kursyen as këtë që i dhembti më shumë: dënimin e të birit.

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
www.shkabaj.net

S'po na lënë meshkujt me marrë frymë!

Rrëfime të ndryshme bëhen ndërmjet studenteve në një ndejë ditëlindjeje në Prishtinë. Në "debat" marrin pjesë kryesisht studente të vitit të parë të universitetit të Prishtinës, të ardhura nga vise të ndryshme të Kosovës...

Vajzat kudo që rrinë bashkë gjejnë tema për bashkëbisedim, e sidomos ato që janë në studime: ligjëratat, profesorët, provimet, ngacmimet e djemve në fakultet, në kafene, në rrugë e ku jo tjetër...

Kjo është e zakonshme dhe ato sikur relaksohen kur shprehen dhe e nxjerrin mllëfin...

A DONË MESHKUJT DASHNORE A GRUA?

"Shoqja ime po del me Vetonin. Boll e bukur, ama budallicë! Sa kalon mirë me Vetonin, sa priset, sa prapë i kthehet!", thotë Jeta, njëra nga vajzat pjesëmarrëse në ndejjen e ditëlindjes së shoqes së saj.

"Po-po, të gjitha femrat kështu po heqin! Për besë, keq. Shumë keq. S'ka mbet njeriu t'i besoj askujt, e lëre më të dashurit", ndërhyjnë Albulena, që shkurt e thërrasin Lena, vajzë nga rajoni i Vitisë. "Hajt bre, lëri ato llafe se ku ka sot djalë

të mirë e që të do pa interes?!", ndërhyjnë Vitorja nga Klina.

A JANË TË GJITHË MESHKUJT PESHKAQENË?

"Çka do të bënin djemtë po të mos ekzistonin femrat?! Sepse, meshkujt janë si peshkaqenë e veç shikojnë ku të të kafshojnë dhe cila është viktima e radhës! A mendojnë, ore, se ne, femrat, jemi të ndjeshme kur dashurojmë?!"

Seriozisht, është shumë e pandershme kjo bëjnë!", ndërhyjnë Lena".

"Po, bre, bash ashtu është. Ne, vajzat, kur dashurojmë, dashurojmë me shpirt e djemtë dashurojnë për kënaqësi! Kur dashuron një femër dashuron shumë më fuqishëm se një mashkull dhe është në gjendje të bëjë gjithçka për dashurinë... Ama, sa për do djem që po i ndërrojnë vajzat çdo ditë e bëhen se po vuajnë, s'kam qejf t'ua fal as sekondën!", thotë Jeta, e

cila pas këtyre fjalëve ia krisë gazit, aq sa i mban brinjët me duar...

KE FOLUR SI IGBALLE RUGOVA!

"Unë mendoj se djemtë e mençur e kuptojnë se për të jetuar një jetë të mirë, u duhet një grua e mençur. Gruaja më nuk do sundim. Ajo dëshiron të jetë e lirë.

Thjesht, i pëlqeu kjo apo jo dikujt...

Ato tash punojnë dhe nuk janë të varura nga askush", thotë me krenari Lena.

"Ke folur si Igballe Rugova!", tallet Jeta dhe vazhdon: "Mos harroni çika, sot jemi në ditëlindje dhe nuk duhet të mendojmë keq, por e lëmë muhabetin për ndonjë herë tjetër se sonte u bë vonë e nesër kam provim te profa "E drejta ndërkombëtare". Dhe, fill pas këtyre fjalëve, vajzat ngrihen dhe, pasi urojnë edhe një herë shoqen e tyre për ditëlindje, drejtohen kah konvikti i tyre me një "natë të mirë" nëpër dhëmbë.

Dritë Haxhaja



Në Spitalin Anaderm, ofrojmë trajtim të specializuar për sëmundjet e venave dhe arterieve duke përdorur dy metoda të avancuara:

Trajtimi me lazer – Ky trajtim minimalisht invaziv është i përshtatshëm për rastet që e lejojnë dhe realizohet shpejt, nuk ka nevojë për hospitalizim. Pacientët rikthehen shpejt në aktivitetet e përditshme.

Trajtimi manual – Përdoret për ato raste ku trajtimi me lazer nuk është i mundur. Kjo metodë ka dhënë rezultate të shkëlqyera në trajtimin e venave dhe arterieve, duke siguruar shërim të plotë për pacientët.



Kosova i ka 1000 plagë në trup!

Të huajt nuk do të qëndrojnë gjithmonë në Kosovë, sepse i kemi lodhur me problemet tona, kryesisht me probleme ndërmjet veti!

Gjashtëmbëdhjetë vjet kisha jetuar i qetë e i lumtur, duke shëtitur andej-këndeje nëpër Kosovë: herë në Republikën e Kosovës e herë të shtetit të Kosovës. Isha takuar me komandantët, por jo edhe me ushtarë të UÇK-së, sepse nuk kam hasur në një të tillë. Sepse, cilido që kishte marrë pjesë në luftë prezantohej si komandant! Sidoqoftë, këndeje ku edhe shtrihet republika, kam bredhur e ecur shumë, ndërkaq

andej lumit Ibër kam kaluar vetëm dy herë!

Dhe, jo që kam frikë, por nuk doja të takohesha me serbët që kanë marrë pjesë në luftë.

Por, edhe pse kaluan dy dekada e gjysmë pas lufte, republika jonë po lëngon akoma. I ka njëmijë plagë në trup. Sikur të dija të bëja poezi, kushedi çfarë poeme do i kushtoja republikës sime.

“Pse i thua republikë?” më tha djali i madh një pasdite, teksa pinim nga një gotë verë të kuqe.

“Ashtu, më ka mbetur në shpirt republika, sepse kemi shpërndarë afishe dhe kemi shkruar parulla për republikën.

Kemi protestuar, madje edhe organizuar demonstrata gjithëpopullore për republikën.

Jemi burgosur, jemi dënuar dhe kemi mbajtur burg për republikën.

Në fund edhe kemi luftuar për republikën...

E, për shtet nuk kemi folur dhe as që e kemi përmendur fjalën shtet. A për bashkim kombëtar po.

Gjithmonë në ballë e kemi pasur flamurin kuq e zi. Në atë kohë për ne buka kishte më pak vlerë se flamuri kombëtar.

E, prej kur u lansua kënga “Kuç e zi”, këngë që i dedikohet flamurit, edhe më shumë u mishërova me të...

Por, me shpalljen e Kosovës shtet u pasuruam edhe me një flamur blu me ngjyra të Evropës.

Mirëpo, kemi një problem: Flamurin e Kosovës nuk po e duan disa politikanë tanë patriotë, e as disa kryetarë të komunave të Kosovës!

Edhe tash, në këto çaste që i shkruaj këta rreshta, më bëhet sikur e shoh tek qante Shpend Ahmeti kur fliste për Albin Kurtin! Lotët i rridhnin deri në mjekër!

E, tash?

A do të qante sërish?!

S. Krivaça



Pse më ka falë Zoti veç për prapë?!

Jeni mësuar të mos besoni, por te ne, në Kosovë, po ndodhë gjithçka... Ka nëna që kujdesen shumë për vajzat e tyre, sa u rrinë gati për çdo gjë, madje edhe të mos dalin nga shtëpia pa tableta kontrceptive!

Përballë shtëpisë sime është shtëpia e tyre, ku edhe po tregohet ky insert... Teksa e parkoj veturën në garazh, e shoh të ecte me hapa të shpejt fqinja ime, për ta zënë në rrugë vajzën që shkonte në qytet. "Hej, prit!", i bërtiti nëna së bijës. Nga zëri vërehej se diçka nuk ishte në rregull me fqinjën, andaj u bëra kureshtar të dija se çfarë po ndodhte me të...

EDHE UNË NJËFARË DREQI PO!

"Hë fqinje, çka u bë?", nuk u durova pa i thënë.

"Eh, more kojshi, ende i ke fëmijët të vegjël dhe nuk e di se sa telashe del me ta kur të rriten!", ma ktheu ajo.

Por, pa një e pa dy më kujtohet anektoda për plakun, që i kishte folur tri fjalë për tri lira dhe them me vete: "Trus aty ku je se ku me ditë ku i del tymi kësaj pune!".

Dhe, sikur të kisha kërkuar, fqinja ndalet para dyerve të oborrit tim dhe pasi flet me të bijën, i thotë:

"A i ke marrë ato?!"

"Kë ato?", i tha vajza.

"Ato, bijë, tabletat..."

"Tabletat kontrceptive, a?"

"Po, bash ato. Shiko a i ke me vete në çantë a jo?"

Vajza hapë çantën dhe, pasi hallakat me njëren dorë nëpër të, i thotë: "Jo, i paskam harruar në dhomë!".

Eh, thashë me vete, edhe këtë e dëgjova!

Kjo qenka temë për shkrim se jo mahi!

Dhe, nga befasia se çka dëgjova, dal para derës së garazhit dhe i them:

"Si je inxhie, a je mirë?"

"Po, mirë jam. U desh të vrapoj pas vajzës se nuk e dija a i ka marrë recetat për do barna a jo, sepse mbarova nga dhimbjet?!"

"Ato barna që i përmendët, a janë për ty a për vajzën?", ia ktheva.

"Do për veti e do për mua! Diçka është ftohur dhe po i dhemb barku!", më thotë me gjysmë zëri.

Sidoqoftë, i kisha futur duart në zjarr po t'më thoshte dikush se Inxhia rrenë!

Dhe, në këto çaste më bie në mend xha Cani, i cili thoshte se njerëzit koriten për pak send...

E, koria ndodh te të gjithë: edhe po të jetë pleqnar, edhe po të jetë politikan, edhe po të jetë dikush tjetër...

Megjithatë, Inxhia që më nje mirë, e di se unë, nganjëherë, edhe mahitem nga pak, andaj edhe i thashë: "Inxhie, mos mendo se unë ha kashtë!"

S. Murturi

Si ta largoj dashnorën nga **mendja!**



Unë dhe gruaja ime, zakonisht, ditën e diel e kalojmë në Gërmi. Një ditë shkurti, derisa pinim kafe në Gërmi, nga larg pash një femër të cilën dikur e kam pasur të dashur.

Dhe, çuditërisht, erdhi dhe u ul në tavolinën afër nesh. Më pas, pasi kamerieri e pyeti se çka dëshiron-te të pinte, ajo ktheu kokën kah unë dhe ma bëri me shenjë se do më thërriste në telefon...

Me shenjen që ma bëri se do më thërriste në telefon, unë mendova se do më provokonte dhe hiç më shumë.

Por, edhe unë i dhashë shenjë se do e thërrisja, meqë numrin e saj, edhe pse kishin kaluar vite e vite, ende e dija përmendësh.

Dhe, pasi pimë kafe, unë e gruaja u ngritëm dhe u nisëm për në shtëpi, kurse ajo ende mbeti në lokalin ku ishim. Rrugës mendoja se si do ia bëja, si do gjeja mundësi të dilja nga shtëpia.

Dhe, deshi fati e gruaja e hapi temën vetë. Më tha se kah mbrëmja do shkojë te nëna e saj, meqë kishte kohë që nuk kishte qenë.

"Asnjëherë nuk të kam bërë pengesë që të shkosh te nëna jote, andaj nuk të pengoj as sot", i thashë, duke e përmbajtur veten, që të mos hetonte gëzimin tim që më erdhi aty për aty.

SI M'U NDEZËN NDJENJAT?

Pasi ajo doli nga shtëpia, shpejt e shpejt e mbylla derën dhe mezi prisja ta thërrisja Valen në telefon.

I thashë se pas një ore do të jem në restorantin tonë të dikurshëm dhe e pres me pa durim.

"Nuk mund të vij, sepse sapo erdhi burri

në shtëpi", më tha me zë shumë të ulët sa mezi e kuptova.

Por, edhe pse m'u prish plani, të nesërmen më thirri ajo.

"Mund të shkojmë ku të duash, por jashtë Prishtinës!", më tha.

Në çast, një flakë ma përshkoi trupin...

PRITJA NË VETURË SI ADOLESHENT!

Prita gati një orë afër restorantit ku e lamë të takohemi. Gjatë pritjes në veturë më dukej vetja si një adoleshent, që nuk di ta vlerësojë mirë realitetin.

Megjithatë, më në fund, erdhi dhe menjëherë e kuptoi përdezjen time dhe sikur donte që aty për aty të më hidhej sipëri... Pas disa kilometrave rrugë, në të djathtë ishin do pisha dhe një rrugicë. E ktheva timonin kah rrugica dhe u ndala skaj pishave.

Valeja menjëherë m'u hodh sipëri...

As vetë nuk e di sa ka zgjatur ajo gjendje, por di se dikur u lodha dhe më nuk mundja as ta puthja...

Por, nga ajo ditë, më nuk kam rahatit në shpirtin tim. Valja më silltet vërdallë nëpër kokë dhe po frikësohem se këtë shqetësim timin një ditë do e kuptojë gruaja ime, e cila nuk e meriton një gjë të tillë.

B. T.

Revolucion në
DOBËSIM
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke pëmbushur ëndrrat e tyre.



39kg 36 sesioni



79kg 30 sesioni



89kg 20 sesioni



119kg 20 sesioni

U kënaq me mua dhe nuk e pashë më!

Jam kosovare, por jetoj në Sarandë. Në korrik të vitit 2023, kur isha 20 vjeçe, erdha pak ditë te tezja në Prizren. Afër shtëpisë së tezës jetonte një djalë bukurorosh, me emrin Asim. Ai ishte i bukuri i dheut ose më dukej mua...

Në fqinjësi të tezës sime shtëpinë e kishte një djalë i ri. Emrin e kishte Asim. Të them të drejtën, që në momentin kur e pashë, më pëlqeu shumë, sa më vinte ta puthja sapo e shihja tek kalonte rrugën apo edhe te shtëpia e tij, sepse e kishte shtëpinë përballë shtëpisë së tezës sime. Kuptoheshim me shikime dhe sa herë që haseshim në rrugë, kuptoja që ai më dëshironte.

Bëra ç'munda që të tërhiqja vëmendjen e tij në mënyrën që doja unë, sepse isha shumë e bindur se do të kishte sadopak

komunikim mes nesh...

Një ditë u ktheva nga ecja rreth kalasë dhe pashë që ai kishte dalë përpara shtëpisë dhe shikonte kah unë.

Më pas erdhi e vajza e tezës dhe aty nisi një shoqëri e bukur mes nesh, edhe pse nuk ishte ajo që doja unë.

NISËM ME SHIKIMIN E NJË FILMI...

Një ditë, sapo kisha bërë dush, po rrija në verandë.

Ai më thirri nga shtëpia e tij dhe më tha: "Sano, do vish të shohim një film bashkë në televizor?"

Zemra më lëvizti nga qejfi dhe i pohova me kokë.

Shkova atje dhe flokët ende nuk më ishin tharë mirë.

Dhe, pasi biseduam gjatë e gjeti një film në një kanal filmash.

Filmi kishte temë dashurie.

Dhe, në një çast, teksa dy personazhet kryesorë putheshin, ai më puthi mua.

AH, AJO NATË...

Në natën tjetër, teksa isha me pizhame, më thirri nga ballkoni i tij. Shkova ashtu

siç isha.

Ndezi televizorin dhe lëshoi një film romantik.

Erdhi një moment në film kur protagonisten e çuan në një shtëpi dhe ajo duhej t'i kënaqte disa meshkuj.

Si me të tallur, Asimi më tha:

"Kjo vajzë e paska trupin e bukur po nuk ta kalon ty, se jam i bindur që ti je shumë më e bukur".

Në atë moment u afrova afër tij dhe fillova ta puthja.

Ishte momenti i duhur që unë dhe ai të bënim atë që unë, por edhe ai, kishim kohë që e ëndërronim...

Ai në fillim hezitoi t'i hynte asaj pune, por më vonë reagoi me puthje. Puthte aq mirë sa që unë nuk përmbahesha dot më dhe vetëm e tërhiqja drejt vetes.

Më pas përfunduam me seks, që zgjati bukur shumë...

NUK E PASHË KURRË MË!

Dhe, me kthimin tim në Sarandë, edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar 2 vjet, më as nuk më thirri në telefon, as erdhi të më sheh, as që u ndie i gjallë!

S., Sarandë

STRONGER
MUSCLES,
STRONGER
MINDSET!



POWER
HOUSE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse flasin njerëzit me vetveten?

Përhëndetje zonjë, ka kohë që jam kureshtarë të di pse flasin njerëzit me vetveten.

E kam parë nënën time disa herë teksa i lëvizë duart pa kontroll në shtëpi, por kam hasur edhe në njerëz në rrugë teksa flasin me veten.

Pse ndodh kjo? A do të thotë se kanë "luajtur"?

"BL"

Përgjigje:

Të folurit me vetveten nuk paraqet rrëshqitje mendore të njeriut dhe nuk do të thotë se ata që flasin me vetveten kanë probleme psikike.

Ata, duke folur me vetveten, i shkarkojnë problemet shpirtërore dhe i heqin nga vetja ngarkesat me të cilat jetojnë prej kohësh, apo që janë bërë pjesë e tij. Realisht, është pak emocionuese kur njeriu flet me vetveten në rrugë, sepse për mentalitetin tonë, por edhe te mentaliteti perëndimor akoma merret si një problem mendor.

Njerëzit, duke folur me vetveten, nxjerrin nga brendia diçka shumë brengosëse që ngulfat shpirtin e tyre.

Thjesht, është shkarkim i energjisë negative.

Shoh ëndrra, a kam pasoja?

Jam grua e martuar, nënë, jetoj në Prishtinë.

Ka dy vjet që jam shumë e shqetësuar nga ëndrrat.

Kur i tregova burrit më tha se të gjithë shohin ëndrra. Por, unë vërtet shoh shumë ëndrra dhe më shqetësojnë.

A ka ndonjë metodë që mund t'i largoj?

"Hëna"

Përgjigje:

Ëndrrat, sipas shpjegimeve shkencore, kalojnë nëpër ne duke prekur sistemin nervor me të qindtat e sekondës dhe kalimi i shpejtë sjell një tabloid përfytyrimi që nuk është i qartë nga pamja, apo shumë rrallë ndodh që të deshifrohet ajo që kalon nëpër ne si një ëndërr që lë pasoja.

Shpjegim të saktë për ëndrrat nuk ekziston, sado që shumë psikologë janë munduar të interpretojnë atë që ndodh brenda sistemit tonë të pushimit me sy të mbyllur.

Në të shumtën e rasteve, ata që më së shumti goditen nga ëndrrat janë njerëzit e ndjeshëm dhe me probleme të përditshme jetësore.

Në pyetjen tënde, përgjigja me e plotë është të mos e ngarkosh veten me frikën nga ëndrrat. Sepse, s'ka njeri që nuk sheh ëndrra...

Pse jemi bërë të ndjeshëm ndaj harresës?

Jam grua 53-vjeçare. Po harrojmë shumë si unë ashtu edhe burri im! Disa po thonë se e kemi nga vaksinat e pandemisë.

Megjithatë, siç po dëgjoj, nuk po harrojmë vetëm ne të moshuarit, por edhe brezat e rinj!
Pse po ndodh kjo?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Harresa sot është dukuri kolektive në botë dhe nuk është vetëm pjesë e të moshuarve, por edhe e të rinjve. Andaj, për këtë dukuri duhet bërë hulumtime.

Sipas hulumtimeve të bëra deri më

tash, harresa shfaqet shkaku i pranisë së telefonit dhe rrjeteve sociale që trurit i sjellin informacione të gatshme pa krijuar memorie të mbamendjes.

Kur nuk ka pasur telefona celularë, njerëzit kanë mbajtur mend me dhjetëra numra të telefonave të miqve, shokëve, familjarëve dhe të zyrës.

E, sot?

Sot nuk mban mend askush asnjë numër telefoni!

Pse?

Sepse, gjithçka regjistrohet në telefon, duke anashkaluar aktivitetet e trurit, i cili humb kapacitetin e mbamendjes!

Gjithashtu, atë që dikur kanë lexuar njerëzit për të mbajtur në mend dhe që e kanë përsëritur leximin, sot e kanë në rrjete sociale si informacion të servuar në çdo kohë dhe kjo i bën njerëzit të mos lodhen të mbajnë në mend të dhënat shkencore.

Truri e ka inercionin e vet kondicional të memories, i cili për të qenë aktiv në çdo kohë duhet të përsëritet diçka...

Pse gruaja është në depresion?

Jam nga Gjilani, i martuar. Jam 39-vjeçar. Gruaja ime është në depresion dhe qe disa vjet trajtohet me barëra.

Arsyen nuk e di...

Kemi fëmijë.

Çka është në pyetje? A i ka bërë kush gjë të keqe?

Je shpresa e vetme, sepse kemi qenë te shumë mjekë, por pa sukses...

"Burri nga Gjilani"

Përgjigje:

Depresioni i paraprijnë shumë faktorë, të cilët e përcjellin njeriun shëndetësisht, zakonisht, stresi depresiv nuk është i bazës mjekësore. Ai ka gjenezë të ndryshme, që njerëzit e kanë hulumtuar prej kohësh, por pa sukses apo me pak sukses.

Është sikur fusha e alergjive që ka akoma mbi 50 për qind të prejardhjeve të pazbuluara.

Depresioni i disa rasteve nuk mund të shpjegohet në këso rrethanash, sepse është në masë të madhe problem që kushtëzohet nga specificiteti psiko-social familjar dhe nga e kaluara konservatore, pastaj nga pakënaqësitë e rastit që mund të krijojë martesë, por edhe nga problemet që mund të sjellë burri

që nuk e përfillë gruan dhe ku mendon se dominimi i tij është parësor.

Ti jeton në Zvicër dhe shpesh vjen në Kosovë.

Dhe, meqë gruaja jote nuk jeton me ty, jeta jote larg saj ka rezultuar me lloj-lloj thashethemesh, të cilat gruan e kanë bërë të pasigurt.

Sepse, nuk janë shpirtrat njësoj, ashtu sikur nuk janë as grupet e gjakut, prandaj një trajtim i mirë i gruas do ta ndihmonte shumë të kthjellonte në familje. Kot i jepni barëra kur ja helmoni zemrën!

Depresioni nuk shërohet vetëm me barëra, por më shumë me sjellje adekuate dhe edukative.

A më do burri?

Jam 51-vjeçare, jetoj në Prishtinë.

Nuk jam e punësuar, edhe pse e kam kryer fakultetin, madje me notë mesatare 9.

I kam tre fëmijë. Me burrë kemi shëtitur dhe akoma shëtisim, por më duket se nuk më do sikur më ka dashur më parë.

Një vit është më i vjetër se unë.

Ndjej se ka ndryshuar dhe ndryshon çdo ditë e më shumë.

Dyshoj se kushtet e mira e kanë bërë të veten!

Kjo është hera e dytë që kam probleme me të. Herën e parë ka pasur lidhje me një femër që punoi sekretare e tij në firmë.

Të lutem, a ka ndryshuar ai apo çka është në pyetje?

“Zoja”

Përgjigje:

Zonjat si ti thonë: Nuk mjafton vetëm të më duash, por edhe të më thuash të dua!

Megjithatë, ana praktike tregon anën e kundërt të monedhës. Më mirë të funksionojë dashuria dhe lidhja në praktikë, sesa të të thotë të dua...

Ju jeni në moshën në të cilën fëmijët paraqesin problem dhe ky problem e thithë kujdesin e njëri-tjetrit.

Mirë është të mos i shikoni tash këto gjëra, sepse është logjika konkrete që thotë: “Burri njihet e mos e duaj, gruan duaje e mos e njih!”

Andaj, përmbahu në këto teori ndër-bashkëshortore dhe nuk do të shohësh pengesa...

Jetoj për nipërit e burrit!

Jam 49-vjeçare, jetoj në rrethin e Prishtinës.

Kam një hall shumë të madh...

E kam burrin 22 vjet më të moshuar se unë. E kam marrë vetë me propozimin e familjes, meqë atij i kishte vdekur gruaja.

Nuk kam fëmijë të mi dhe, zakonisht, merrem me nipërit e burrit.

Nëse i thonë kësaj jetë nuk e di, por di se nuk jam e lumtur me asgjë...

Si e sheh të ardhmen time dhe çka të bëj tutje?

“E brengosura”

Përgjigje:

Shoh se burri yt është i sëmurë. Nuk ka shenja të dorëzimit, por nuk është mirë me shëndet dhe herë pas herë nuk është i aftë për punë...

Ka qenë shumë gabim që je përcaktuar për martesë me të, sepse e ardhmja jote nuk është e sigurt me të.

Ka mundësi që fëmija e tij të të dëbojnë nga shtëpia.

Është vështirë që fëmija e një nëne tjetër ta durojnë një grua tjetër, me të cilën nuk i lidhë asgjë.

Të sugjeroj të bësh kurorë me burrë ani pse është i vjetër, sepse kështu, të paktën, nuk mbetesh rrugëve...

Pse njerëzit nuk më duan?

Zonja magjistare, të shkruaj nga një vend i vogël evropian, nga Luksemburgu.

Jam 38-vjeçare, nënë e dy fëmijëve. Jam ndarë nga burri para 5 vjetësh.

Punoj dhe i rrisë fëmijët.

Por, kam një hall. Të gjithë ikin prej meje! Nuk më ofrohet askush, edhe pse unë nuk u bëj keq asgjë.

Shqiptarët më janë larguar shumë.

E, kjo po më dhemb në shpirt, sepse nuk po kam me kë ta ndaj asnjë brengë.

Çka të bëj që ta riftoj rrethin tim?

“Zonja nga Luksemburgu”

Përgjigje:

Ti jeton në një vend të vogël dhe çdo gjë merret vesh shpejt, kuptohet shpejt.

Ke pasur lidhje me një banor të

atjeshëm dhe të kanë dalë shumë

fjalë si grua pa burrë, andaj rrethi të

shmanget.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Sugjerimi im është të sillesh mirë me njerëzit përreth dhe të bëhesh nënë e mirë dhe edukatore për fëmijët...

Nuk po kam fat!

Jam 26-vjeçare, nga Prishtina.

E kam kryer fakultetin, por nuk po gjej punë.

E dua një djalë, por nuk di a do të jetë fati im. Emri i tij fillon me shkronjën M.

Si më sheh në këtë lidhje dhe a do të martohem me të?

“E dashuruara”

Përgjigje:

Je në lidhje që pesë vjet. Para tij ke pasur dikë tjetër dhe ky është problemi kryesor që ju shpesh prisheni e herë pajtoheni...

Andaj, edhe ke pasiguri në lidhje.

Ai dyshon se ti mund të rikthehesh te i pari, ndërsa ti dyshon se mund të të lërë shkaku i të parit.

Sidoqoftë, do të bëheni bashkë.

Do të fejohehi dhe gjatë muajit shtator edhe do të martoheni.

A do ma japin hisen familja?

Përsëritet, jam grua 47-vjeçare, e martuar që 19 vjet.

Por, martesë ka qenë pa dëshirën e familjes sime...

Nuk i kam kushtet e mira në shtëpi, kurse familja ime i kanë kushtet shumë të mira.

Nuk di a do ma japin familja një banesë, edhe pse hisja ime do të ishte shumë më e madhe se aq?

“Arta”

Përgjigje:

Shoh se është aktualizuar kjo temë në shtëpinë tënde.

Mos thuaj se burri do hise, por po e kërkon ti.

Përndryshe, lind inati te familja jote dhe, edhe nëse e kanë ndërmend të të japin një banesë, i bien pishman.

Përditshmëri në kryeqytetin tonë...



Lum burri që të paska, oj dadë!

Në këtë kohë pandemie më nuk ka lezet asgjë. Secili është bërë më egoist se tjetri. Ndërsa, ata që kanë bërë biznes e para, mendojnë se mund të të blejnë edhe ty, si maunat me mall nga Serbia!

Ulem në një kafiteri për të pir kafe dhe pas pak dëgjoj fjalët: "Doni duhan?". Nuk kalon shumë kohë dhe, përsëri, vjen tjetri për duhan...

Dhe, edhe pse nuk dua të flas me asnjëri, me një fjalë dua të jem e qetë, përsëri njeriu është i shtrënguar të flasë dhe për një minutë duhet t'u japë përgjigje shitësve, të cilët janë të shtrënguar të fitojnë hiq më shumë se bukën e përditshme...

E, ajo fitohet kush si mundet...

Ndonëse kjo të prish imazhin e qetësisë dhe për një çast të bëjnë nervoz dhe detyrohesh, ndonjëherë, edhe

t'ua kthesh me ton të lart, madje edhe t'i fyesh, apo t'i lusësh të të lënë të qetë...

Por, shpeshherë, kur mendon se si do të ndihen ata, kjo të shqetëson shumë...

Dhe, pa dyshim, bëhesh egoist sa që nuk mund ta njohësh as vetveten.

E, kjo, pa dyshim, na ndodhë çdo ditë...

Edhe kur i japim në rrugë lëmoshë ndonjë plake a plaku, këtë e bëjmë për egon tonë...

Edhe në shkollë, në punë, e kudo tjetër, vazhdon e njëjta reprizë...

Por, ajo që më la mbresë të pashlyeshme, është ndodhia teksa shëtisja me time shoqe në sheshin e Prishtinës.

"Lum burri që të paska, oj inxhe! Sa e ke "çmimin?", i tha një i ri shoqes sime, nga katër shokët që ishin bashkë, teksa kaluan pranë nesh.

Ndërkaq, ime shoqe, duke mos i përfillur fjalët e tij, vetëm buzëqeshi dhe vazhduam rrugën.

Por, as sot e kësaj dite nuk po më hiqet nga mendja fjalja: "Lum burri që të paska, oj inxhe! Sa e ke "çmimin?".

Diturie Haxhaj



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr **FEHIM HALITI**



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC